



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 11.03.2025

Nr: 261

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË DENONCIMIN
NR. 57 ID, DATË 06.03.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË PARTISË
DEMOKRATIKE

Sot më datë 11.03.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

KËRKUES: Partia Demokratike

SUBJEKT: **Zj. Majlinda Bufi**
Kryetar për Bashkinë Roskovec

OBJEKT: Konstatimi i kryerjes së veprimtarive të ndaluara nga kryetarja e Bashkisë Roskovec, Majlinda Bufi dhe marrjen e sanksioneve administrative

BAZA LIGJORE: Neni 19, pikat 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator

KONSTATOJ:

Partia Demokratike më datë 06.03.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet poratlit të denoncimeve, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 57 ID.

Në këtë denoncim Partia Demokratike parashtron sa vijon:

“Në datë, 24.01.2025, Bashkia Roskovec ka njoftuar tenderin me objekt “Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në Njësinë administrative Strum”, me vlerë fondi limit 59.111.172 lekë ose rreth 600 mijë euro. Tenderi është zhvilluar në datën 10.02.2025 dhe fitues është shpallur shoqëria “Caushi M” sh.p.k, në datën 17.02.2025, me ofertë fituese në vlerën 41.083.400 lekë plus TVSH. Kontrata parashikon një kohëzgjatje 6 mujore. Vihet re se kjo procedurë prokurimi është njoftuar, zhvilluar dhe shpallur fitues i saj pas datës 11 Janar 2025, që përkon me periudhën e ndalimeve për disa veprimtari të caktuara.”

Data: 11.03.2025

Nr: 261
Ora: 12:00



“Për fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 57 ID, datë 06.03.2025, të regjistrin të denoncimeve, të Partisë Demokratike”

Nga sa më sipër çmoj se, ekzistojnë kushtet për t'u nisur hetimi administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj:
 - Zj. Majlinda Bufi, Kryetar i Bashkisë, Roskovec.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI